

- ▶ MTI NË AVANCIM TË POLITIKAVE
TREGTARE 2
- ▶ FILLUAN DITËT
E BIZNESIT TË VOGËL 2
- ▶ FUQIZIMI I GRAVE I RËNDËSISHME
PËR REDUKTIMIN E VARFËRISË NË
KOSOVË..... 2
- ▶ TË BËRIT BIZNES DHE INVESTIMET
NË KOSOVË PREZANTOHEN NË
HUNGARI 3
- ▶ KOSOVA SHEMBULL I BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET SEKTORIT PUBLIK
DHE PRIVAT 4



MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

Buletini

Nga 1 gushti, hiqet taksa prej 35 për qind e vendosur për çimento

Pas analizave të kryera nga Departamenti i Tregtisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari-Lila ka nënshkruar vendimin për përfundimin e masave mbrojtëse në import të çimentos, vendim ky që largon plotësisht taksën prej 35 për qind të aplikuar gjatë periudhës së masave të përkohshme.

Masat e përkohshme, të ndërmarra me 11 qershor 2012, kanë arritur qëllimin e tyre meqë kanë parandaluar fluksin e pakontrolluar të importit të çimentos, posaçërisht gjatë sezonit të ndërtimit. Ato gjithashtu kanë siguruar stabilitet për prodhuesin vendor dhe kanë mundësuar shtim të kapaciteteve vendore në industrinë e ndërtimit. Arsye të kanë shtyrë në çrregullimin e tregut të çimentos, kanë të

bëjnë me fluksin e çimentos së lirë nga Italia, e cila edhe përkundër taksës ka vazhduar të importohet në Kosovë, por edhe me vështirësitë në procesin e prodhimit në Kosovë të lidhura me qasjen në lëndë të parë, përditësimin e teknologjisë prodhuese dhe kushtet e përgjithshme fiskale në Kosovë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke punuar në hartimin e një liste të plotë të produkteve vendore, për të cilat do të shqyrtohet marrja e masave sezonale për mbrojtjen nga importi i pakontrolluar. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të vazhdojë që së bashku me ministrinë tjetra, në kuadër të Qeverisë së Kosovës, të shikojë dhe të gjejë mënyra për të siguruar një ambient sa më të mirë operues për të gjitha kompanitë prodhuese, pa marrë parasysh prej nga vijnë



dhe në pronësi të kujt gjenden ato.

Përkundër zhurmës së krijuar nga individ të caktuar për t'ju shërbyer interesave personale, MTI beson se mënyra e zhvillimit të procesit, në përputhje të plotë me Ligjin për Masat Mbrojtëse, ka treguar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që t'ju ndihmojë prodhuesve vendorë me qëllim të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Shqyrtohet heqja e licencave në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik

Nën udhëheqjen e Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari – Lila, njëherësh edhe kryesuese e këtij këshilli u mbajt takimi i tretë me radhë i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KZHE). Zv.kryeministria Kusari – Lila foli për rolin, të arriturat nga takimi paraprak, si dhe hapat e mëtejshëm të KZHE-së. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është duke vazhduar punën dhe se rekomandimet e dala nga ky këshill adresohen me shumë seriozitet. Në takimin e kaluar, që është mbajtur më 6 qershor 2012, Oda Amerikane e Kosovës ka rekomanduar rishqyrtimin e ligjit të punës, konkretisht pushimin e lehonisë.

Kurse ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq dha përgjigje për këtë: “Është bërë një analizë e këtij ligji dhe se ne e kemi dërguar në Komisionin Parlamentar në prill të këtij viti, mirëpo ende jemi në pritje të një përgjigje”, - tha ai, duke treguar se në bazë të vlerësimeve që ministria që ai drejton kanë bërë, punësimi i femrave ka rënë dukshëm. Zyra për Shërbime Juridike në Zyrën e Kryeministrit prezantoi një raport të shkurtër për paraqitjen e licencave nga nëntë ministri, të tjerat do të shqyrtohen në takimin e radhës. Në këtë takim u miratua themelimi i Komisionit ndër-ministrior për projektin e ndërtimit të hidrocentralit të Zhurit, ku Ministri i Zhvillimit Ekonomik, me vendim

do të formojë komision. Po ashtu, në këtë takim, u vendos që të ketë nga asociacionet e pranishme të dërgojnë nga një përfaqësues si vëzhgues të këtij procesi. Si hapa të ardhshëm për takimin e radhës mbeti kompletimi i listës së licencave dhe lejeve nga secila ministri dhe agjenci shtetërore, si dhe themelimi i Grupit Punues të udhëhequr nga Zyra për Shërbime Juridike në Zyrën e Kryeministrit për reformën në Sistemin e Lejeve dhe për Gijotinë të licencave. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është organi kryesor këshillues dhe vendim-marrës për politikat ekonomike dhe reformat, i cili mbahet çdo muaj. Ky këshill përbëhet nga 11 ministri, 3 asociacione të biznesit dhe donatorë që ndihmojnë projektet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.



MTI në avancim të Politikave Tregtare

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me datën 20 qershor 2012, mbajti takimin e tretë të Grupit Punues për Politikë Tregtare, ku u prezantuan aktivitetet e ndërmarra deri më tani për avancimin e politikave tregtare në Kosovë. Në fjalën e saj hapëse, ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari-Lila, tha “Si rezultat i dialogut në mes të komunitetit të biznesit

dhe institucioneve përgjegjëse për tregti, ku përmes këtij grupi janë zgjidhur një numër i problemeve të ngritura nga bizneset, por edhe janë marrë parasysh komentet që janë dhënë gjatë draftimit të ligjeve që rregullojnë tregtinë”, tha ministrja Kusari – Lila. Ajo shtoi se kohë më parë patëm rastin e dëmtimit të tregut nga importi i mishit të pulës, që pas analizave të bëra është vërejtur se ka pasur damping, më pas patëm rastin e importit të çimentos që ndikoi në deformimin e tregut, kur morëm vendim për masat e përkohshme të mbrojtjes. Në këtë takim morën pjesë edhe

udhëheqësi i njësisë për Kosovën në Këshillin Evropian, Lawrence Meridith dhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme për Tregti në KE, Alfio Anzalone, të cilët prezantuan synimet e institucioneve që ata përfaqësojnë. Ky takim dhe takimet tjera, në kuadër të këtij grupi, kanë për qëllim ofrimin e mundësive për të gjithë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve, që ndikojnë në zhvillimin e politikave tregtare, si dhe në identifikimin e mënyrave për të përmirësuar kornizën ligjore në dobi të ekonomisë së tregut dhe interesit të bizneseve.



Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (AMNVM), që vepron në kuadër të MTI-së, prej datë 27 qershor e deri më 30 nëntor 2012 do të organizojë aktivitetet të shumta nëpër të gjitha komunat e Kosovës për “Ditët e Biznesit të Vogël”, që ka për qëllim forcimin e dialogut publiko-privat. Me këtë rast, zëvendëskryeministria dhe ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari – Lila tha se sektori privat, në veçanti NVM-të, konsiderohet si sektor kyç për zhvillimin ekonomik. “98.4 për qind e ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë janë mikro-ndërmarrje, që punësojnë 1 deri në 9 punëtorë dhe këto të dhëna na tregojnë se NVM-të janë bosht i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe krijimit të një ardhme prosperuese të qytetarëve në përgjithësi”, tha Kusari-Lila. Ajo shtoi se reformat e ndërmarra kanë për qëllim lehtësimin e ambientit për të bërë biznes, si dhe për implementimin e strategjisë për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (2012-2016). Këtë projekt për herë të dytë e mbështet Zyra e BE-së në Kosovë. Ndërsa për herë të parë, këtë vit, USAID ka mbështetur financiarisht këtë projekt. Kurse, kryeshefi i AMNVM, Granit Berisha, prezantoi qëllimin dhe aktivitetet që janë planifikuar të mbahen gjatë periudhës 5 mujore. Ai sqaroi se iniciativa “Ditët e Biznesit të Vogël” është paraparë me qëllimin e 5-të të strategjisë së NVM-ve. Ditët e Biznesit të Vogël mundësojnë forcimin e procesit të Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Të gjitha aktivitetet e këtij projekti do të shpallen në ueb-faqen www.smallbusinessdays.com

Fuqizimi i grave i rëndësishme për reduktimin e varfërisë në Kosovë

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë tradicionalisht organizon panairin e grave. Këtë vit, në një pjesëmarrje të nivelit të lartë, u mbajt konferenca “Gratë në LiderShip dhe Ndërmarrësi”, ku u diskutuan sfidat dhe përparësitë që femrat kanë në liderShip. Zv.kryeministria dhe ministrja e MTI-së, Mimoza Kusari-Lila, që është një zë i fuqishëm për fuqizimin e grave në Kosovë, tha se duhet të ngritët vetëdija për rolin dhe rëndësinë e gruas në shoqëri: “Nuk dëshiroj që femrat gjithmonë të kenë një kuotim, nuk jam e kënaqur që të bëjmë ndarjen se në kuvend 30 për qind e deputetëve duhet të jenë

femra. Nëse shikohet në bazë të statistikave, ne përbëjmë numrin më të madh të popullatës, e nëse merret kjo për bazë atëherë duhet të jemi më tepër të pranishme”, - tha ajo. Mysafirja speciale e kësaj konference, Fatma Sahin, Ministre e Familjes dhe Politikave Sociale në Republikën e Turqisë mbajti një fjalë rasti ku prezantoi politikat që Qeveria e Turqisë është duke ndërmarrë për gratë në vendin e saj. Pas përfundimit të fjalëve të rastit, në këtë konferencë u mbajt një panel me temën “Fuqizimi i gruas në sektorin publik dhe privat”, ku panelistet e këtij sesioni ishin: ministrja Kusari-Lila, e cila foli

për liderShipin e grave në sektorin publik, Maureen Shauket, Drejtore Misioni USAID, e cila informoi për programet që ofron misioni që ajo drejton si dhe për rëndësinë e grave në ndërmarrësi, Ebru Ozdemir, kryetare e investimeve në Limak, ku ndau eksperiencën e saj nga perspektiva e sektorit privat si dhe Efka Heder, Drejtore e Qendrës Evropiane Jug-Lindore për mësim të ndërmarrësisë, e cila dha kontributin e saj në aspektin e edukimit të femrave për ndërmarrësi. Në përfundim të konferencës, Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe Mesme, në kuadër të “Ditëve të Biznesit të Vogël” organizoi edhe ekspozitën e shoqatave të grave, ku secila nga to ekspozuan produktet dhe shërbimet që ato i ofrojnë. Si pjesë e kësaj iniciative, MTI ka dhënë donacion SOS Fshatit të Fëmijëve në darkën bamirëse të organizuar një ditë më parë.



Të bërit biznes dhe investimet në Kosovë prezantohen në Hungari



Zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari – Lila mbajti fjalim në forumin ekonomik “Të bërit biznes dhe investimet në Kosovë”, të organizuar nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që u mbajt me 13 qershor në Budapest, ku morën pjesë 40 kompani kosovare dhe 100 kompani hungareze. Në fjalimin e saj, zv.kryeministrja Kusari – Lila u bëri thirrje bizneseve hungareze të investojnë në Kosovë. Duke folur për ambientin e të bërit biznes, ajo prezantoi potencialin ekonomik dhe iniciativat aktuale të Qeverisë së Kosovës në drejtim të përshejtit të zhvillimit ekonomik. “Reformat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës tashmë kanë sjellë rezultate konkrete. Kosova ka një nga sistemet më të mira të TVSH-së në Evropë, jemi duke eliminuar barrierat teknike dhe jo-tarifore me vendet e rajonit, në mënyrë që ekonomia e vendit tonë të jetë më e hapur, konkurruese dhe nën kornizat e rregullave të OBT-së dhe kërkesave të Unionit Evropian”, theksoi Kusari-Lila. Si pjesë e vizitës u nënshkrua marrëveshjeve bilaterale në mes të AAPIK-ut dhe Agjencisë për Tregti dhe Investime të Hungarisë.

Graçanica, Lipjani dhe Shtimja me qendër të re për regjistrim të biznesit

“ Reformat nuk janë të lehta asnjëherë dhe prezantimi i rezultateve është një sinjal pozitiv për të vazhduar me reformat e radhës ”



Zëvendëskryeministrja dhe Ministri e Tregtisë dhe Industrisë inauguroi tri qendra të reja të biznesit të njohura si “One Stop Shop”, në Graçanicë, Lipjan dhe Shtime.

Biznese të shumta nga këto komuna detyroheshin të udhëtonin deri në Prishtinë për të regjistruar biznesin e tyre dhe më pas për të shkuar në Administratën Tatimore të Kosovës për të marrë numrin fiskal. Tash e tutje, bizneset nga këto komuna do ti kenë shërbimet më afër dhe më të shpejta. E shoqëruar nga kryetari i komunës së Graçanicës Bojan Stojanović, ministrja Kusari – Lila, inauguruan Qendrën Komunale të Biznesit. Më pas ajo vazhdoi në komunën e Lipjanit, ku u prit nga kreu i kësaj komune, Shukri Buja. Qendra e regjistrimit e 25-të me radhë u hap edhe në Shtime, ku ministrja u prit nga i pari i kësaj komune z.Naim Ismaili. Në ceremoninë e hapjes, ministrja e Kusari-Lila, tha se hapja e qendrave one stop shop e lehtëson procedurat e regjistrimit të biznesit të kësaj komunave: “Reformat nuk janë të lehta asnjëherë dhe prezantimi i rezultateve është një sinjal pozitiv për të vazhduar me reformat e radhës” – theksoi ajo. Ndërsa kjo qendër u mirëprit nga kryetarët e komunave të cilët u zotuan se puna në këto qendra do të kryhet me efikasitet.

Sistemi i metrologjisë elementi kyç për përmirësimin e infrastrukturës

Me datë 17 korrik, Departamenti i Metrologjisë së Kosovës, që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nënshkroi memorandum bashkëpunimi me Institutin e Metrologjisë Kombëtar të Turqisë. Përmes kësaj marrëveshje metrologjia e Kosovës do të mbështetet nga Instituti i Metrologjisë së Turqisë në disa fusha, duke përfshirë rregulloret teknike dhe standardet, shkëmbimin e njohurive shkencore dhe teknike, zbatimin e projekteve të përbashkëta për zhvillimin e metrologjisë, shkëmbimin e informatave, organizimin e seminareve dhe konferencave dhe harmonizimin e rregulloreve teknike. Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, në fjalën e saj hapëse,

“ Kjo marrëveshje është tejet e rëndësishme për ne, sepse sistemi i metrologjisë është elementi kyç për përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë në Kosovë ”

tha: “Kjo marrëveshje është tejet e rëndësishme për ne, sepse sistemi i metrologjisë është elementi kyç për përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë në Kosovë”. Ajo shtoi se Kosova ka nevojë për mbështetje nga vendet që kanë një përvojë në zhvillimin e sistemit të mirëfillt të metrologjisë dhe se Turqia është një shembull i mirë për këtë. Kjo marrëveshje mbështet krijimin e infrastrukturës së domosdoshme metrologjike (laboratorët e akredituar të

kalibrimit, etalonët nacionalë, metrologët profesionistë) me qëllim të vendosjes së saktësisë dhe besueshmërisë në Kosovë dhe ngritjes së cilësisë së produkteve dhe shërbimeve në Kosovë. Gjatë ditës, përfaqësuesit nga Instituti i Metrologjisë nga Turqia, të shoqëruar nga zyrtarë të Departamentit të Metrologjisë, kanë vizituar Laboratorin e verifikimit të njehsorëve në KEK dhe në Institutin e Shëndetësisë Publike. Ndërsa gjatë ditës së nesërme do të vizitohen Laboratorin e ujëmatësive, si dhe punëtoritë e metaleve të çmueshme dhe artizanaleve në Prizren. Pas vizitave do të konkretizohen edhe detajet për mbështetjen që mund të japë instituti i metrologjisë së Turqisë.

Kosova shembull i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe privat

Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari Lila mori pjesë në Forumin “Leadership kundër Krizës dhe Partneriteti Publiko Privat për Zhvillim”, që u mbajt në Selanik të Greqisë, i organizuar nga Këshilli i Biznesit për Evropën Juglindore.

Ajo, në panelin me temën “Bashkëpunimi për tranzicion, investime dhe zhvillim: roli i komunitetit të biznesit”, foli për politikën dhe praktikën e bashkëpunimit publiko-privat në Kosovë, si dhe rolin e këtij bashkëpunimi për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

Ky forum është organizuar për të shënuar 15 vjetorin e ekzistimit të Këshillit të Biznesit për Evropën Juglindore. Ky Këshill është iniciuar nga bizneset dhe organizmat regjionale të E.J.L., me qëllim të krijimit të një rrjeti ndërmjet bizneseve, organizatave dhe sektorit publik për të fuqizuar bashkëpunimin dhe zhvillimin ekonomik rajonal dhe përfshin në vetë udhëheqës të kompanive që gjenden në Fortune 100, siç është Muhtar Kent, CEO i Coca Cola Company; Andrew Liveris CEO i Dow Chemicals dhe Temel Atay nga KOC Group.



Zv.kryeministrja Kusari- Lila priti Zv. ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Kelly C. Degnan



Zv. kryeministrja dhe Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë znj. Mimoza Kusari-Lila në një takim njoftues priti zv. ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Kelly C. Degnan së bashku me zyrat e lartë për Ekonomi Andrea J. Tomaszewicz. Gjatë këtij takimi Kusari – Lila e informoi znj. Degnan rreth punës së Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, të cilin ajo e kryeson, duke vënë theks të veçantë në përfshirjen e të gjitha ministrave të sektorit ekonomik dhe asociacioneve të biznesit. Gjithashtu në takim u prezantua edhe promovimi i politikave të ndërmarrja nga MTI-ja në përkrahjen e prodhimeve vendore. Gjatë bisedës u përmend rëndësia e ngritjes së kapaciteteve menaxhuese të ndërmarrësve dhe rëndësia e lëndës së ndërmarrësisë në shkollë. Më tutje, ajo theksoi faktin se bashkëpunimi me sektorin privat dhe shoqatat industriale është i një rëndësie mjaft të veçantë. Sa i përket iniciativave të reja, zv.kryeministrja/ministrja Kusari-Lila e informoi zv.ambasadorin për iniciativat legjislative të MTI-së, si për Zonat e Lira Ekonomike dhe për Ligjin për Investimet e huaja.

Gjatë këtij takimi, me një interes të veçantë, u paraqit edhe organizimi i Konferencës për Investime në SHBA, e cila do të mbahet me 25 shtator në Uashington DC, në bashkëpunim me AmCham dhe Odën Ekonomike të SHBA-ve në DC. Gjithashtu, zv.ambasadorja u njoftua edhe rreth përgatitjeve për konferencën e investimeve, e cila do të mbahet në Prishtinë me 7 nëntor të këtij viti. Në takim u diskutua edhe për fuqizimin e gruas në ndërmarrësi dhe në jetën publike në Kosovë. Zv. ambasadorja shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të dyanshëm në mes të dy institucioneve.

Qeveria e Kosovës përkrah ndërmarrësinë dhe inovacionin

Ndërmarrësit kosovarë nga tani e tutje kanë një vend, një shtëpi ku mund ta fillojnë dhe të ndërtojnë biznesin e tyre. E gjithë kjo mundësohet nga hapja e Qendrës Inovative në Kosovë, e cila ka për qëllim përkrahjen e ndërmarrësve, inovacioneve, si dhe zhvillimin e bizneseve komerciale.

Në hapjen e kësaj qendre, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, shprehu përkrahjen e kësaj iniciative: “Qeveria e Republikës së Kosovës përkrah ndërmarrësinë, inovacionin e bazuar në teknologjinë informative”, -theksoi kryeministri Thaçi. Ai shtoi se zhvillimi i sektorit privat është prioritet për Qeverinë e Kosovës.

Ndërsa, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e MTI-së, Mimoza Kusari – Lila theksoi se teknologjia informative është esenciale për reformat e të bërit biznes: “Me anë të teknologjisë informative, bizneset kanë qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në dokumente”, tha Kusari-Lila.

Kurse, drejtoresha e kësaj shoqate, Vjollca Çavolli foli për historikun dhe sfidat që i kanë pasur deri në realizimin e hapjes së qendrës. Qendra e Inovacionit të Kosovës ofron mundësi të mirë për të zhvilluar ide të biznesit.

Kjo qendër u themelua me ndihmën e Norvegjisë, STIK si dhe Crimson Capital.



Shkëmbimet tregtare të Kosovës gjatë gjashtëmujorit të parë 2012

Shkëmbimet tregtare të Kosovës gjatë gjashtëmujorit të parë 2012 kanë arritur vlerën rreth 1.2 miliard euro.

Importet shënuan vlerën mbi 1.122 mil/€, vlerë më e lartë për

1.9 %

në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

Sa i përket importeve ato shënuan vlerën mbi 1.122 mil/€, vlerë më e lartë për 1.9 për qind në raport me periudhën e njëjtë (janar – qershor) të vitit 2011. Mallrat e eksportuara në këtë periudhë kohore kapin vlerën prej 133 mil/€ dhe me një rënie prej 20.5 për qind. Gjatë kësaj periudhe mbulimi i importit nga eksporti është 11.9 për qind. Tregtia me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e rajonit (CEFTA) përbëjnë pjesën dërmuese të tregtisë së jashtme të Kosovës, përkatësisht 72 për qind të tregtisë së përgjithshme.

Mallrat e eksportuara në këtë periudhë kohore kapin vlerën prej 133 mil/€ dhe me një rënie prej

20.5%.

Kusari – Lila mori pjesë në hapjen e Panairit Natyra 2012

Zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari – Lila nën organizimin e shoqatës së përpunuesve kosovarë, mbajti fjalim në edicionin e tetë me radhë të panairit “Natyra 2012”.

Duke iu drejtuar bizneseve të pranishme në këtë panair, zëvendëskryeministrja Kusari –Lila theksoi se prodhimi dhe tregtia janë tejet të rëndësishme:

“Ky panair çdo vit shton pjesëmarrjen e kompanive vendore dhe kompanive të huaja. Kosova ka më tepër nevojë për prodhim dhe unë shpresoj që numri i prodhuesve të rritet edhe me



tepër”- theksoi ajo.

Me këtë rast, zv.kryeministrja Kusari-Lila u bëri thirrje të gjithë konsumatorëve të vizitojnë panairin dhe të shikojnë prodhimin kosovar

dhe i inkurajoi kompanitë të jenë bashkëpunues dhe të shfrytëzojnë sa më mirë të gjitha resurset që i ofrojmë për bizneset kosovare dhe ato ndërkombëtare.

Kusari – Lila: “Konsoni” shembull i mirë i zhvillimit të biznesit

Në inaugurimin e linjës së re të therjes dhe përpunimit të pulave “Konsoni”, të mbajtur me 7 qershor, zv.kryeministrja, Mimoza Kusari – Lila tha se “Mbrotjtja e prodhuesve vendorë nga praktikat jo-lojale e ka përcjellë punën tonë në vazhdimësi”. Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë tregoi rastin e “Konsonit” dhe masat anti-damping që ka ndërmarrë ministria që ajo e drejton. Më tutje,

ministrja Kusari-Lila tregoi edhe raste e tjera, ku MTI-ja ka marrë masat adekuate për mbrojtjen e prodhuesve vendorë, siç janë reciprociteti me Serbinë, mbrojtja e prodhuesve të qumështit nga konkurrenca jo-lojale me Shqipërinë, reagimi i menjëhershëm për bllokimin e importit të miellit nga Maqedonia, si dhe raste tjera të cilat kanë ndikuar direkt tek prodhuesit kosovarë.

Regjistrimi i bizneseve gjatë gjashtëmujorit të parë 2012

Numri i regjistrimi i bizneseve gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti është 5241 biznese. Prej tyre Biznese Individuale 4320, Ortakëri të Përgjithshme 116, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar 757, Ortakëri e Kufizuar 1, Shoqëri Aksionare 10, kompani e Huaj 32, Ndërmarrje Shoqërore 3, Kooperativë Bujqësore 2. **Shuarja e bizneseve gjatë gjashtëmujorit të parë 2012** Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë shuar 500 biznese. Sipas kategorive janë shuar këto biznese: 460 Biznese Individuale, 15 Ortakëri të Përgjithshme, 23 Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, 2 Kompani të Huaja.

Tregtia në shifra

Qarkullimi tregtar i Kosovës me vendet e BE-së

Qarkullimi tregtar i Kosovës me vendet anëtar të CEFTA-s:-

:- janë në vlerë prej 419 mil/€ ose me një rënie për 6.5 për qind. Nga kjo statistikë shihet se vlera e importit është 370 mil/€ ose 33 për qind nga vlera e përgjithshme e importit. Këto vlera tregojnë një rënie të importit me këto vende për 9.4 për qind në raport me gjashtëmujorin e parë të vitit 2011.

Ulje e importit me këto vende për

9.4 %

në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Eksportet me destinacion ndaj vendeve të rajoni, anëtare të CEFTA-s, kapin vlerën prej 48 mil/€ ose 36.5 për qind nga vlera totale e eksporteve, që tregon ecuri pozitive për arsye se është më e lartë për 22.7 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Ngritje e eksportit për

22.7 %

në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

-produktet e importuar dhe të eksportuara drejt tregjeve të BE-së gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti kanë shënuar ndryshime, konkretisht tek importet kemi rritje dhe tek eksportet nga vendet e BE-se kemi ulje. Për këtë kohë vlera e importit është mbi 428 mil/€ ose 38 për qind nga vlera totale e importit, dhe me rritje prej 9 për qind në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2011. Nga kjo rezulton se brenda vendeve të BE-së kemi një dominim të importeve nga vendet si:

Gjermania me vlerë mbi 130 mil/€ ose 11.6 për qind e importeve të përgjithshme në Kosovë, 30.5 për qind e importeve totale nga BE-ja, si dhe rritje për 8.7 për qind nga periudha e vitit paraprak. Vend tjetër me rëndësi në importet e Kosovës zë edhe Italia, me vlerë prej 93 mil/€ ose 8.4% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 57.7 për qind.

Sipas destinacionit edhe gjatë kësaj periudhe një pjesë e madhe e eksporteve të Kosovës kanë qenë të orientuara drejt vendeve

Ulje e importit me vendet e BE


9%

në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

te BE-së, duke arritur vlerën eksportuese mbi 55 mil/€ ose 41.6 për qind nga vlera e përgjithshme e eksportit dhe me një rënie prej 28.8 për qind.

Partnerët kryesorë eksportues, janar - qershor / 2012, në përqindje (%)


Italia	Shqipëria	Maqedonia	Mali i Zi	Zvicra	Serbia	Turqia	Gjermania	India
29.8	14.2	9.5	6.2	6.1	5.0	4.6	3.3	5.3



Më se 84 për qind të eksporteve të përgjithshme të Kosovës janë të destinuara në vendet e paraqitura në grafikunin e mësipërm.

Partnerët kryesorë importues, janar - qershor / 2012, në përqindje (%)

Maqedonia	Gjermania	Serbia	Turqia	Italia	Kina	Shqipëria	BeH
12.3	11.6	10.5	7.9	8.4	6.6	3.8	3.2



Mallrat e importuara në Kosovë nga vendet e paraqitura në grafikun janë më se 64.3 për qind.

**MBROJTJA
E KONSUMATORIT**

Thirrni **Falas** në
0800 11000